

RENDI I DITËS

**Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 97, subjekti ankues
një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë”**

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 12 dhjetor 2023, ora 14:27 zhvillohet seanca e shortit “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 97, me ankues një grup deputetësh prej 15 vetash, që i drejtohen Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve me objekt kundër vendimit të KSHZ për rrëzimin e kërkesës së Koalicionit “Bashkë Fitojmë” për të shpallur të pavlefshme dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetrait të Bashkisë Kuçovë, zotit Kreshnik Hajdari. Procedura për caktimin e relatorit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në njërin prej tyre është shënuar kërkesa ankimore nr. 97. Katër shiritat e tjerë janë të bardha e pa shënime. Futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Anëtarët e KAS-it nuk janë prezent në zhvillimin e seancës për caktimin e relatorit, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre. Fillojmë me rendin alfabetik rritës duke filluar së pari me zotin Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe në fund zotin Ledio Braho. Të pestë goglat janë në një enë transparente. Pasi përzjehen nga një përfaqësues i KQZ-së,

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Elvin Lako: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.12.12.2023*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Elvis Çefa: – Kërkesa ankimore nr. 97.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Ilirjan Rusmali: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Koli Bele: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Ledio Braho: – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 97, u caktua zoti Elvis Çefa. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

